



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1580/3 prot.

Tiranë, më 11.08.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1580/1, DATË 26.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE SË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. ILIR MUZHAQI"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e z. Ilir Muzhaqi, me nr. 2322 prot, datë 31.08.2022; nr. 2322/2 prot, datë 12.10.2022 dhe nr. 2322/3 prot, datë 16.11.2022, ndaj veprimtarisë gjyqësore të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë, Kavajë dhe me vendimin nr. 1580/1, datë 26.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Ilir Muzhaqi", bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Institucioni i Ekzekutimit të Veprave Penale, Rrogozhinë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

